

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit [REDACTED]
[REDACTED] nga fsh. [REDACTED], K. Shtime, për shkak të rimbursimit të dëmit, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 23.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -

- I. **APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. **DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] K. Shtime, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) t'ia rimbursojë mjetet në emër të kompensimit të dëmit, në shumë prej **655.00 €** (gjashtëqind-e-pesëdhjetë-e-pesë-euro) me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.
- III. **OBLIGOHET** paditësja të paguaj taksën gjyqësore për padi në shumë prej 20€, menjëherë pas pranimit të kopjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, për rimbursimin e mjeteve në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti me motoçikletë. Si provë, paditësja ka sjellur raportin policor mbi aksidentin në komunikacion nr.2012-AU-0189 i datës 02.07.2012; vendimin mbi kompensimin e dëmit BKS: FK-1447/2012 i datës 11.10.2012; ujdinë jashtëgjyqësore nr.1447/12 i datës 19.10.2012 dhe urdhërpagësën e datës 20.11.2012.

Gjykata, të paditurit, me datë 19.02.2016 ia ka dërguar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar nga i padituri me datë 27.02.2016) brenda afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tillë nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se i padituri e ka pranuar me rregull padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi (personalisht), gjykata bazuar në nenin 150.6 të LPK-së, ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësinë për nxjerjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamatinë ka vendosur në bazë të nenit 378 të LMD-së, duke qenë se për paditësen, lartësia e borxhit ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

Gjykata ka obliguar të paditurin për kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore në bazë të nenit 452.1 të LPK-së, ndërsa paditësen në bazë të nenit 12.1 të UA nr.01/2017 të KGJK-së, për unifikiminë e taksave gjyqesore.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.90/16, më datë 23.11.2017

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II / DROŠEVAC

Më
Dana



Gjyqtari,

Misim Frangu

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.